Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0605

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahimi Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Besim A. Zejnullahu B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender me numër të prokurimit 214-23-13757-2-1-1, me 27/09/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE Besim A. Zejnullahu B.I me nr. 2024/0605 , e datës 05/07/2024, kurse vendimi i AK Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender me numër të prokurimit 214-23-13757-2-1-1 ndwrsa mbetet nw fuqi njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 18.06.2024.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Besim A. Zejnullahu B.I.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 18.12.2024, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 21.06.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "Doctor Exterminator DDD" Sh.p.k.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim me vlerë të parashikuar të kontratës 316,560.00 euro.

Me 25.06.2024, OE Besim A. Zejnullahu B.I ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 28.06.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Besim A. Zejnullahu B.I me numër protokolli 0605/2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender me numër të prokurimit 214-23-13757-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Besim A. Zejnullahu B.I janë parashtruar si në vijim: *Pretendimi i pare (I): "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit duke e eliminuar OE ankues për Certifikimet me standardet ISO. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor: AK në dosjen e tenderit ka tek kërkesat mbi mundësitë teknik dhe/ose profesionale ka përcaktuar kërkesat si vijon: "1.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 2. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 3.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001:2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit." Dëshmitë e kërkuara për këto kërkesa janë: "1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje). 2. Certifikata ISO 14001 2015 (kopje). 3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje)." AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 21.06.2024 ka dhënë arsyetimin për eliminimin e OE ankues si vijon: "Ju për këto kërkesa kem dorëzuar SO standarde 1SO 9001 2015, 050 14001 2015 dhe 150 45001 2018 për anëtari e grupi të operatorëve ekonomik Besim A. Agnullahu Ba, por nuk keni dorëzuar fare ISO standardet për anëtarin e grupi te operatoreve ekonomik TRESOR HOME L.L.C sis është kërkuar ne dosje të tenderit, AK me datën 06.06.2024 përmes letrës standarde por sqarim ka kërkuar që te na dërgon kopja e ISO standardeve për anëtarin e grupi te operatoreve ekonomik TRESOR HOME L.I.C, sipas kërkesave ne dosjen e tenderit, Ju nuk koni dorëzuar fare dëshmi qe është kërkuar përmes letrës standarde brenda afatit te përcaktuar ne letër standarde e as me ofertën tuaj. Andaj bazuar ne nenin 70 te LPP-së dhe Nenit 26 pika 6 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik ku thuhet se: Certifikatat për sigurimin e cilësisë përmenden ne menin 70 te LPP-se që kanë për qëllim vërtetin e përputhshmërisë se operatori ekonomik me një numër të caktua standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata te*

hartuara nga organe te pavarura që bëjnë aktivitete te certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde le caktuara për sigurimin e cilësisë qe bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do te dështoj se i përmbush standardet përkatëse. Oferta juaj është refuzuar dhe nuk kalon në vlerësimin e mëtutjeshëm". Grup i OE-ve Besim A. Zejnullahu B.I.; TRESOR HOME L.L.C. në ofertë ka dorëzuar certifikatat për standardet ISO 9001:2015, ISO 14001 2015 dhe ISO 45001 2018, për OE Besim A. Zejnullahu B.I. AK me datë 06.06.2024 përmes letrës standarde për sqarimin e tenderit ka kërkuar nga OE ankues sqarime shtesë si vijon: "Për të vlerësuar tenderin tuaj në mënyrë të duhur, bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-së, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit tuaj si në vijim: Kërkesat: 1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide, ISO 14001 2015 valide, ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. Dëshmitë: 1. Certifikatat ISO 9001 2015, ISO 14001 2015, ISO 45001 2018 (kopje). Ju për ketë kërkesë ne ofertën tuja keni prezantuar ISO standardet e lartcekura për OE Besim A. Zejnullahu B.I, por nuk keni ofruar ISO standardet për anëtarin e konzorciumit TRESOR HOME L.L.C. Andaj bazuar ne nenin 70 te LPP dhe paragrafin 26.6 te nenit 26 te Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik ,kërkojmë nga ana juaj qe te na dërgoni kopjet e ISO standardeve për anëtarin e Konzerciumit TRESOR HOME L.L.C, sipas kërkesave ne dosjen e tenderit . Kërkesat : 8. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Certifikatat e Analizave dhe MSDS për te gjitha preparatet e kërkuara te specifikimet teknike. Dëshmitë : 8. Certifikatat e Analizave dhe MSDS. (kopje) Ju për ketë kërkesë keni prezantuar një broshurë te produkteve dhe disa certifikata për analiza për preparatet e kërkuar dhe MSDS, andaj ne mënyrë qe komisioni i vlerësimit te të beje vlerësimin e drejte te ofertave dhe te këtë me te letë vlerësimin dhe ekzaminimin e certifikatave te analizave dhe MSDS-t e, ju lutem qe specifikoni ose markoni ose ndërlidhni artikujt e ofruar me broshure me certifikatën e analizave (p.sh. ne secilën certifikat te analizave te shënohet "certifikata për pozicionin 1 sipas katalogut ose broshurës, e njëjta vlen edhe për MSDS-t")." OE ankues me datë 10.06.2024 ka ngarkuar përgjigjen me tekstin si vijon: "Në bazë te kërkesës suaj ne po ju sqarojmë kërkesat e juaja si ne vijim: Sqarimi për kërkesën 1 -Bazuar ne Nenin 7414 te LPP se ne si OE kemi dorëzuar me oferte certifikatat e kërkuara në emër te grupit, Sipas këta neni secili anëtar i grupit është i obliguar te dëshmojë ose konfirmojë ne përputhje me nenin 67 te këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja ne aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligi Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligi do te aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndal anëtarëve individual te grupit. Në Nenin 71 te LPP se është e cekuar mire se çka duhet te ofroje secili anëtar i grupit dhe ne këtë Nen nuk është cekur se kërkesa sipas nenit 70 do te aplikohet ndaj anëtarëve individual te Grupit, po ashtu ju si AK ne Dosje te tenderit këtë kërkesë e keni vendosur te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale gjë që ne si grup i posedojmë certifikata e kërkuara. Sqarimi për kërkesën 2. Ne kemi prezantuar një broshurë te produkteve pasiqë është si kriter në dosje te tenderit te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te kërkesa ne 7. Operatori Ekonomik ose grupit operatorëve ekonomik duhet te dëshmojë Katalog ose Broshure me përshkrim teknik dhe foto për te gjithë preparatet e kërkuara. Sipas radhitjes së produkteve në këtë broshurë ne ju kemi bashkangjitur edhe Certifikatat e Analizave dhe MSDS-te por si duket ju nuk i keni analizuar mire, qe ne secilin dokument shënohet emri dokumentit dhe emri i preparatit. Por, ne serish ju ridërgojmë dokumentet e kërkuara sipas kërkesës suaj." OE ankues ka bashkangjitur si provë interpretimin e KRPP-së me numër të referencës KRPP-DRR-07-06-88/2024 të datës 07.06.2024. "Konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.8 te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar ne pyetjet e parashtruara, KRPP sqaron

dispozitat e LPP-se, si ne vijim: Sa i përket pyetjes se pare, KRPP sqaron: Rregulla për grupin e operatorëve ekonomik përcakton neni 71 i LPP dhe neni 26 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Paragrafi 4 i nenit 71 te LPP-se, përcakton: "Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatoreve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë ne përputhje me nenin 67 te këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja ne aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 te këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 te këtij ligji do te aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual te grupit". "Licenca" si kërkesë, përmendet ne nenin 66.2 te LPP-së dhe ne përputhje me paragrafin 4 te nenit 71 te LPP-se, një kërkesë e tillë aplikohet ndaj grupit si tërësi. Pra, mjafton njeri anëtar i grupit te këtë dëshminë për Licencën e specifikuar ne Dosjen e Tenderit dhe ne Njoftimin për Kontratë dhe te konsiderohet se kërkesa është përmbushur. Sa i përket pyetjes se dyte, KRPP sqaron: Neni 26,6 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (në tekstin e metejmë "RRPP"). përcakton: "26.6 Certifikata për sigurinë e cilësisë, përmendën ne nenin 70 të LPP-së dhe kane për qellim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurinë e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata te hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete te certifikimi për te vërtetuar se operatorët ekonomik përmbushin standarde te caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose adertomberare, secili anciar i grupit do të dëshmojë se i përmbush standardet përkatëse" Hartimi i Dosjes se Tenderit është kërkesë e nenit 27 te LPP-se dhe nenit 17 te RRPP-ës. Në përputhje me nenin 17.12 te RRPP-ës, "Ne dosjen e tenderi AK do të deklaron te gjita informatat relevante për kontratën ne fjale që OE-të të interesuar duhet të dijnë për pergatitien e tenderëve pa kërkuar informata shtesë, Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali ne dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi qe dosja e tenderit është materiali themelor, ne baze te cilit operatorit ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet ne mënyrë të tillë , që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë." Vendosja e Kërkesave, kritereve, kushteve specifikimeve apo dëshmive ne Dosjen e Tenderit dhe ne njoftimin për Kontratë është kompetence dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues Ne përputhje me paragrafin 1 të nenit 51 të LPP-së, "Në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kritere të përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç aty të lejuara nga dispozicionet e neneve 65-70 të këtij ligji". Ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 56 t LPP-ës. "Tenderuesi, gjatë procedurës së hapur, ose kandidati gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla na bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderi Sipas nenit 59 te këtij ligji, vlerësimi i tenderëve është kompetence dhe përgjegjësi e plote e autoritet kontraktues. Sipas paragrafi 4 të neni 59 te këtij ligji. Autoriteti kontraktues do ta konsideroje një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."

*Pretendimi i dytë (II) : "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit pasi që OE i rekomanduar për shpërblim me kontratë nuk ka dorëzuar asnjë katalog ose broshurë në dosje të aplikimit. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 2: AK, në dosjen e tenderit, përkatësisht seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kapaciteti teknik dhe profesional: 9.1 & 9.2.; ka përcaktuar kërkesën me numër rendor 7: "Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë Katalog ose Broshur*ë me përshkrim teknik dhe foto për të gjithë

preparatet e kërkuara; 7. Operatori Ekonomik (OE) , duhet te sjellë katalogët ose broshura për preparatet e kërkuara, Katalogët ose Broshurat, duhet te jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe të jenë në përputhje me kërkesat ne Aneksin 1 të dosjes se tenderit."

Pretendimi i tretë (III) : "OE ankues pretendon se AK e ka rekomanduar për kontratë OE ne kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, duke mos qenë i pajisur për te gjitha produktet me certifikata të analizave dhe MSDS për të gjitha preparatet e kërkuara. Përkatësisht për preparatin repellent Rodent Sherif për deratizim pika c, sipas ankuesit mungon certifikata e analizave dhe preparati Noë Solution – Castor Oil sipas SDS nuk dëshmohet si repellent, por është produkt Essential oils (vajra esenciale). Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 3: AK, në dosjen e tenderit, përkatësisht FDT, kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Kapaciteti teknik dhe professional: 9.1 & 9.2.; 8. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë Certifikatat e Analizave dhe MSDS për te gjitha preparatet e kërkuara te specifikimet teknike.; 8. Certifikatat e Analizave dhe MSDS. (kopje). Më tej në aneksin 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme; Deratizimi; pika c) OE duhet te përdorë preparate RODENTICIDE, (helmet) për eliminimin e minjve ndërsa në disa objekte si bodrume, vendet afër trafove, kabllove elektrike etj., përreth hyrjeve duhet të vendosen preparate repelente adekuate kundër brejtësve (minjve) ne forme të granulave apo sprej me origjine organike prej përbërësve natyror dhe qe nuk janë te rrezikshme për njerëzit dhe ambientin. Preparati i tillë përdoret ne bazë te etiketës se produktit dhe nevojave ne teren si dhe sipas kërkesës nga menaxheri i projektit."

Pretendimi i katërt (IV) : "OE ankues pretendon se AK e ka rekomanduar për kontratë OE ne kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit, pasi që i mungon certifikata e analizave për preparatin repelues për insekte Mint Insect & Pest control, per te cilin është prezantuar vetëm SDS dhe 2. Ndërsa preparati i ofertuar si repelent insekticid Nature in Bottle -Peppermint Essential Oil nuk është repelent insekticid por preparat që përdoret për të qetësuar lëkuren nga pickimi i insekteve. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 4. AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit në lidhje me Aneksi 1. Specifikimet teknike të detyrueshme, Dezinsektimi piga g) Ne disa hapësira gjelbëruese përreth objekteve, me qellim te largimit te insekteve duhet te përdoren preparate repelente kundër insekteve ne forme te granulave qe nuk janë te rrezikshme për njerëzit dhe ambientin. Repelentet mund te jene edhe ekuivalnte (ne forme spreji, likuid , koncetrat etj)."

Pretendimi i pestë (V) : "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit duke shpërblyer fituesin edhe përkundër mungesës se certifikate se analizave për produktin për largimin e shpendëve JT eaton TRANCPARETN 4 THE Bird repellent (ne forme gelli) dhe JT Eaton Transparent 4 the Bird repellent likuid) i cili nuk është kërkuar ne dosjen e tenderit. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 5 AK në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit në lidhje me Aneksi 1. Specifikimet Teknike të Detyrueshme, 2.Parandalim i zhvillimit/largimi i dëmtuesve tjerë dhe atë si: gjarpërinjve, zvarranikeve të ndryshme, shpezëve etj. Pika i) Për largimin e shpendëve duhet te përdoren preparate repelente ne forme te gellit me përmbajtje Canfora oil ose ekuivalente."

Pretendimi i gjashtë (VI) : "OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke rekomanduar për kontratë OE i cili nuk plotëson kërkesën e kapacitetit teknik dhe profesional për kontrata të ngjashme të realizuara në vlerë. Rrethanat e çështjes lidhur me pretendimin ankimor 6: AK në dosjen e tenderit ka tek kërkesat mbi mundësitë teknik dhe/ose

profesionale ka përcaktuar kërkesat si vijon: "9. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë duhet te kenë te përfunduar kontrata për shërbimet të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo më pak se 200,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë." Për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës, AK si dëshmi dokumentare që OE-të duhet të dorëzojnë ka përcaktuar: "9. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjiten dëshmi kopjen e certifikatës, (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e caktuara në listë." OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Listën e kontratave në të cilën evidentohen 13 kontrata. Sipas të dhënave të prezantuar, kontrata me numër rendor 4,6 dhe 13 përfundojnë në vitin 2024, pra pas datës së publikimit të njoftimit për kontratë që është data 18.12.2023. Ndërkaq, lidhur me kontratë me numër rendor 1 me titull "Deratizimi, Dezinfektimi dhe Dezinsektimi i Ndërtesave Qeveritare qe menaxhohen nga MPB-Ritender" me numër të prokurimit 214/20/028/211, OE e ka prezantuar si marrëveshje bashkëpunimi. OE ankues në kërkesën për rishqyrtim dhe në këtë ankesë ka bashkangjitur këtë kontratë në të cilin evidentohet se AK-MPB ka nënshkruar kontratë me një subjekt tjetër D.D.D SH.P.K.-Prishtine me numër unik identifikues 811319955. Në kontratë në Neni 4, Nen-kontraktimi përkatësisht paragrafi 1,në të cilin shënohet "Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje te shkruar përmes se cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese te kontratës se tij një pale te trete." Më tej në paragrafin tjetër 2 përcaktohet: "Elementet e kontratës qe do te nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen te ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 dite pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë". OE ankues kishte paraqitur në kërkesën për rishqyrtim pretendimin ankimor se kjo kontratë nuk duhet të merret parasysh meqë GOE i rekomanduar nuk ka qenë i deklaruar si nën kontraktor në kuadër të kësaj kontrate. Në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK lidhur me këtë pretendim ka dhënë arsyetimin si vijon "Ky kriter është plotësuar ne harmoni me kërkesat e AK-se duke tejkaluar dukshëm kërkesën edhe nëse nuk i merre për baze kontrata qe ju pretendoni mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar."

Duke u referuar kërkesave si më sipër Besim A. Zejnullahu B.I konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 6, 7, 28, 51, 56, 59, 60, 69, 69.4, 71, 72, 108/a te LPP-se si dhe Vendimi i OSHP-se nr. 2023/0642 te datës 08.12.2023 dhe vendimi nr. 2023/0626 te datës 03.11.2023 Interpretimi Ligjor i KRPP-se i datës 07.06.2024 me nr.KRPP-DRR-07 -06- 8812024. Kërkojmë nga OSHP re merr : Vendim te 1.Aprovohet si e bazuar ankesa e GOE. "Besim A. Zejnullahu B.J ; Tresor Home L.L.C " lidhur me tenderin Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. te prokurimit 214-23-13757-2-1-1. 2. Anulohet njoftimi për dhënie te kontratës dhe lënda te kthehet ne rivlerësim. 3. Shpërblehemi me kontrate ne si GOE i përgjegjshëm pasi qe ne i plotësojmë kriteret e kërkuara te DT-se dhe te shpërblehemi me kontrate."

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: *"Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 1 - Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ose profesionale.1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë*

së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide përfushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 2.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 3.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. Dëshmi: 1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje). Certifikata ISO 14001 2015 (kopje). 3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje). Ju për këto kërkesa keni dorëzuar ISO standardet ISO 9001 2015, ISO 14001 2015 dhe ISO 45001 2018 për anëtarin e grupi të operatorëve ekonomik Besim A. Zejnullahu B.I, por nuk keni dorëzuar fare ISO standardet për anëtarin e grupi të operatorëve ekonomik TRESOR HOME L.L.C siç është kërkuar ne dosje te tenderit, AK me datën 06.06.2024 përmes letrës standarde për sqarim ka kërkuar qe te na dërgon kopjet e ISO standardeve për anëtarin e grupi të operatorëve ekonomik TRESOR HOME L.L.C, sipas kërkesave ne dosjen e tenderit, Ju nuk keni dorëzuar fare dëshmi qe është kërkuar përmes letrës standarde brenda afatit te përcaktuar ne letër standarde. Autoritetin Kontraktues -Ministria e Punëve të Brendshme ka vepruar në harmoni të plotë me Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik neni 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata lë hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse. Ndërsa sa i përket vendimeve të OSHP nr. 2023/0642 vlen të theksohet fakti së OE ankues është thirrur gabimisht në këtë pike së ky vendim flet për kohë që ka qenë në fuqi RRUOPP. e cila ka qen në fuqi deri me datën 01.11.2022 dhe nga kjo datë ka hyr në fuqi RREGULLORJA Nr.001/2022 PËR PROKURIMI Ne cila e sqaron saktë këtë çështje. Gjithashtu këtë situatë e sqaron edhe me teje interpretimi i KRPP-së i datës 29. 22.06.2023 Sipas nenit 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, në rast se AK kërkon Certifikatë që vërteton përshtatshmërinë e produktit me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë, në rast grupi të operatorëve, certifikata e tillë a duhet të kërkohet nga të gjithë anëtarët e grupit apo mjafton njëri nga ata të jetë i pajisur me këtë certifikatë? Në përputhje me nenin 26.6 të Rregullores për Prokurimin Publik, " Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim të vërtetojnë përshtatshmërinë e operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde te caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse ".Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit lë kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001.., secili anëtar i grupit duhet të jetë ipajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit. Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qarlazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë

sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit. Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njofiimin për kontratë, do t i specifikojë qartë kërkesat që duhet l i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre. Gjithashtu sa i përket vendimeve të OSHP nr. 2023/0626 vlen të theksohet fakti së OE ankues është thirrur gabimisht edhe në këtë vendim sepse kërkesat e AK-së kanë të qarta ashtu siç janë sqaruar ma lartë. Siç shefet nga Pretendimi i OE-së qëllimisht është munduar të keqinterpretoj nenin 26.6 devijim i nenit nga 26.6 ne 26.5 sepse neni 26.6 qarte e thekson se ne raste te koncersiumit certifikata e sigurisë se cilësisë (ISO Standardet) secili anëtarë I grupit duhet te dëshmoj se i plotëson standardet përkatëse, pra kemi te bëjmë me certijikata te cilësisë e jo Autorizime /Licenca e Certifikata te biznesit siç është thirr eksperti. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 2. Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ ose profesionale. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjithë dokumentacioni e nevojshëm (katalogët ose broshura certifikatave te analizave dhe MSDS-t e,) sipas kërkesave të AK dhe e plotëson në plotësi këtë kërkesë pra nuk qëndron fare pretendimi u juaj. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 3 Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ose profesionale. 7. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë Katalog ose Broshurë me përshkrim teknik dhe foto për të gjithë preparatet e kërkuara., 7. Operatori Ekonomik (OE), duhet te sjellë katalogët ose broshura për preparatet e kërkuara, Katalogët ose Broshurat, duhet te jenë të shoqëruara me përshkrim të detajuar të specifikimeve teknike dhe të jenë në përputhje me kërkesat ne Aneksin 1 të dosjes se tenderit. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar të gjithë dokumentacioni e nevojshëm (katalogët ose broshura) sipas kërkesave të AK dhe e plotëson në plotësi këtë kërkesë pra nuk qëndron fare pretendimi u juaj. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 4 Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ose profesionale. dhe Aneksin 1 të DT-së. Ju sqarojmë së sa i përket preparatit Rodent Sheriff, kompania prodhuese nuk ofron certifikatë te analizës por vetëm MSDS në të cilën specifikon përbërjen e saktë të produktit dhe tregon qëllimin e përdorimit në repelimin e brejtësve. Sa i përket preparatit NOË Solution Castor Oil, OE fitues ka ofruar MSDS dhe Certifikatën e analizave për repelimin e brejtësve dhe insekteve. Sipas hulumtimeve tona kemi gjete se Castor Oil (Vaji i ricinit) është: Natyral dhe jo toksik - Vaji i ricinit është një mënyrë natyrale dhe jo toksike për të larguar brejtësit, duke e bërë atë një alternativë më të sigurt ndaj repelentëve me bazë kimike. Vaji i ricinit është një mënyrë shumë efikase për të larguar brejtësit, pasi ka një erë dhe shije të fortë, të pakëndshme që i pengon ata të hyjnë ose të qëndrojnë në një zonë. Vaji i ricinit mund të mbetet efektiv për disa javë, në varësi të përqendrimit dhe metodës së aplikimit të përdorur. Vaji i ricinit (castor oil) ka përdorim të gjithanshëm: repelues, si dhe për përdorim human. Mbështetur nga shtjelliinet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 5 Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të

*tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ ose profesionale, dhe Aneksin 1 të DT-së OE i rekomanduar për kontratë sa i përket produktit Mighty Mint Insect & Pest Control, kompania prodhuese nuk ofron certifikatë të analizgs por vetëm MSDS në të cilën specifikon përbërjen e saktë të produktit dhe tregon qëllimin e përdorimit në repelimin e insekteve. Mighty Mint Insect & Pest Control është një spray me bazë bimore (peppermint oil - vaj i mentës) që vret në mënyrë efektive insektet dhe i mban ato larg pa kompromentuar sigurinë për njerëz. Formula është bërë me vaj esencial të mentës, i cili është i mirë dokumentuar si një parandalues shumë efektiv për insektet, duke përfshirë insektet fluturuese dhe zvarritëse. Sa i përket produktit Nature In Bottle, OE fitues posedon MSDS dhe certifikatën e analizës, si dhe është një preparat organik për përdorim të shumëfishtë si: repelimin e insekteve. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 6 Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë, Dosje të tenderit dhe Aneksin 1 të DT-së OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar tri produkte për repelimin e zogjve, ku dy prej tyre: JT Eaton Transparent 4 the Bird Repellent dhe JT Eaton Transparent 4 the Bird Repellent Liquid , kompania prodhuese ofron MSDS me të cilët saktë specifikon përbërjen e saktë të produkteve dhe tregon qëllimin e përdorimit në repelimin e zogjve. Sa i përket produktit të tretë Nature In Bottle, OE fitues posedon MSDS dhe Certifikatën e analizës, si dhe është një preparat organik për përdorim të shumëfisht si: repelimin e zogjve. Sipas hulumtimeve tona kemi gjet së Peppermint Oil (Vaji i mentës) është një mënyrë natyrale dhe efektive për të larguar zogjtë nga zonat e padëshiruara. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Përgjigje në pretendimin Ankimor nr. 7 Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të tenderit dhe Aftësia Teknike dhe/ ose profesionale. Kërkesa 9. Operatori Ekonomik ose grupi i operatoreve ekonomik duhet te dëshmojë duhet te kenë te përfunduar kontrata për shërbimet të ngjashme, shuma e të cilave kanë qenë në vlerë jo më pak se 200,000.00 €, të realizuar në tri vjetët e shkuara, para datës së publikimit të këtij njoftimi për kontratë., Dëshmi: 9. Lista e kontratave, projekteve me të cilën saktësohen shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Listës duhet ti bashkëngjit*en dëshmi kopjen e certifikatës, (certifikatave) ose referencës, të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat dhe projektet e caktuara në listë. *Ky kriter është plotësuar në harmoni me kërkesat e AK-së duket tejkaluar dukshëm kërkesën edhe nëse nuk i merre për bazë kontrata që ju pretendon. Mbështetur nga shtjellimet e lartpërmendura ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar."*

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0605/2024, ndërsa me datë 26/08/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0605 me rekomandimet si në vijim: *Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues dhe teknik i propozojnë panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.*

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Pergjigje ne pretendimin e parë: *"Eksperti sqaron se interpretimi i KRPP-së lidhur me kërkesat për standardet e sigurimit të cilësisë, e vë theksin tek kujdesi i formulimit të kërkesave apo kritereve në dosjen e tenderit nga AK-të, rrjedhimisht përcakton se çdo fjali ne dosjen e tenderit*

do të përpilohet mirë, pasi qe dosja e tenderit është materiali themelor. Në këtë kuptim formulimi i kërkesës nga AK ku thuhet se "Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik...." nuk saktëson se në rast grupi të gjithë anëtarët duhet të përmbushin kërkesën. Duke qenë kështu, ne përputhje me paragrafin 3 te nenit 56 të LPP-ës ku thuhet se tenderuesi, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është cekur ne njoftimin e kontratës dhe ne dosjen e tenderi, atëherë arsyeja e eliminimit nuk qëndron. Rrjedhimisht pretendimi ankimor është i pabazuar."

Përgjigje në pretendimin e dytë : "Ekspertja teknike fillimisht sqaron se në bazë të dokumenteve 2, 3, 4, 5 dhe 6 pretendimi i listuar nga OE ankues si "shkelja nr.3" nuk qëndron për faktin se OE i shpërblyer nga AK i ka prezantuar dëshmitë te cilat faktikisht janë broshura dhe katalogë te produkteve te ofertuara me specifikat përcjellëse. Duke qenë kështu, ekspertja vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar."

Përgjigje në pretendimin e tretë : "Pas verifikimit te dokumenteve të dorëzuara sipas te pretendimeve te ankuesit, ekspertja teknike sqaron se pretendimi nr. 4 qëndron, për arsye se, për preparatin repelent Rodent Sherif nuk është prezantuar certifikate e analizave por vetëm SDS (fletë të dhënash sigurie). Ndërsa preparati Noë Solution – Castor Oil nuk dëshmohet se është repelent në bazë të SDS, certifikatave te prezantuara dhe hulumtimeve për produktin e ofertuar në foto."

Përgjigje ne pretendimin e katërt: "Pas verifikimit te dëshmive të dorëzuara me ofertë, ekspertja sqaron se pretendimi nr. 5 qëndron, për arsye se, për preparatin repelent insekticid Migty Mint Insec & Pest Control nuk është prezantuar certifikate e analizave por vetëm SDS (fletë të dhënash sigurie). Gjithashtu preparati i ofertuar si repelent insekticid Nature in Bottle Peppermint Essential Oil ne baze te SDS dhe certifikatës se analizave nuk është repelent insekticid por përdoret ne kozmetike apo për trajtim në lëkurë si qetësues nga pickimi i insekteve."

Përgjigje ne pretendimin e pestë: "Pas verifikimit te dosjeve sipas te pretendimeve te ankuesit, ekspertja sqaron se pretendimi nr. 6 qëndron, për arsye se për asnjërin nga preparatet repelente për shpendët nuk janë dëshmuar Certifikatat e analizave në dosjet e aplikimit."

Përgjigje ne pretendimin e gjashtë:"Eksperti sqaron se nga lista e kontratave të dorëzuara OE i rekomanduar kishte evidentuar se 3 kontrata (4, 6 dhe 13) nuk kanë qenë të përfunduara në kohën e publikimit të njoftimit për kontratë, rrjedhimisht nuk mund të merren për bazë si kontrata të realizuara për të dëshmuar përmbushjen e kërkesës së AK-së. Më tej, lidhur me kontratën me numër rendor 1, OE ankues si provë ka paraqitur kontratën e lidhur në mes të AK-MPB dhe OE D.D.D SH.P.K, e në të cilën nuk shënohet se OE i rekomanduar ishte palë, përfshirë edhe si nën kontraktor. Për me tepër edhe në vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim AK duke mos dhënë asnjë provë, në mënyrë të tërthortë e merr si të mirëqenë mos përfshirjen e kësaj kontrate si dëshmi për përmbushjen e kriterit. Megjithatë, AK arsyetohet se kontratat tjera e përmbushin kriterin e vlerës prej se paku 200,000.00 të kontratave të ngjashme. Eksperti sqaron se pa u llogaritur kontrata me numër rendor 1, 4, 6 dhe 13, shuma e përgjithshme e kontratave tjera të realizuara (2, 3, 5, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12) sipas listës së kontratave janë në shumë 182,195.60 euro. Rrjedhimisht nuk dëshmohet përmbushja e kërkesës së dosjes së tenderit të përcaktuar nga AK. Andaj, pretendimi ankimor është i bazuar në këtë pikë. "

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se është e nevojshme edhe mbajtja e seancës dëgjimore me palë, e cila u mbajtë me datë 23.09.2024. Në seancën dëgjimore moren pjesë të gjitha palët që janë pjesë e procesit, duke perfshire perfaqesuesin e AK ; ekspertin shqyrtues si dhe ate teknik ,; perfaqesuesin e OE ankues. Në seancë degjimore ishin të pranishëm edhe monitorues nga D+ si dhe monitorues nga GLSP . Seanca filloj pa vonesë ku të gjitha palët e përfshira në procedurë patën mundësinë që të prononcohen dhe të dorëzojnë edhe fjalën përfundimtare të tyre me shkrim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1". Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues përderisa Paneli Shqyrtues konstaton se raporti i hartuar nga të dy ekspertët nuk është i hartuar në mënyrë profesionale dhe i bazuar në prova dhe argumente, ngase asnjëri prej ekspertëve nuk ka vlerësuar gjendjen reale kundrejt OE të rekomanduar për kontratë,

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Lidhur me pretendimin e parë ankimor PSH Paneli Shqyrtues ka gjetur që në rastin konkret nuk është aspak kontestues fakti që operatori ekonomik ankues ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme. Ky fakt si i tillë përmban shkelje të dispozitave ligjore të nenit 70 të LPP-së dhe dispozitave ligjore të nenit *Rregullore Nr. 001/2022 Për Prokurimin Publik neni 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë të cilat kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë ku secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse., me* kete rast OE nuk ka përmbushur kriteret e vendosura ne DT ku : *.1. Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 2015 valide përfushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 2.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 14001 2015 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. 3.Operatori Ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 45001 2018 valide për fushën e këtij aktiviteti te prokurimit. si Dëshmi: 1. Certifikata ISO 9001 2015 (kopje). Certifikata ISO 14001 2015 (kopje). 3. Certifikata ISO 45001 2018 (kopje).,* PSH lidhur me këtë kërkesë konstaton se OE ankues ka dorëzuar ISO standardet për anëtarin e grupi të operatorëve ekonomik Besim A. Zejnullahu B.I, por nuk janë doruzuar fare ISO standardet për anëtarin e

grupi të operatorëve ekonomik TRESOR HOME L.L.C ashtu siç është kërkuar ne dosje te tenderit, po ashtu Paneli Shqyrtues verteton se AK me datën 06.06.2024 përmes letrës standarde për sqarim ka kërkuar qe te dërgohen kopjet e ISO standardeve për anëtarin e grupi të operatorëve ekonomik TRESOR HOME L.L.C, sipas kërkesave ne dosjen e tenderit edhe pas pranimit të kësaj kërkese nga ana OE ankues nuk janë dorëzuar dëshmit që janë kërkuar përmes letrës standarde nga ana e AK-se. Për Panelin Shqyrtues është fakt notor se kjo kërkesë ka të bëjë me operatorin ekonomik e cila në mënyrë automatike kategorizohet si kërkesë e nenit 70 dhe dipozites ligjore te nenit 26.06. të Rregullores për Prokurimin Publik, dhe të cilën duhet ta ofrojnë të gjithë anëtarët e grupit. Andaj, në konsistencë edhe me vendimet tjera të OSHP për raste të ngjashme edhe në këtë rast Paneli Shqyrtues e mbështet AK, disa nga vendimet e OSHP me NR. 2024/0280, 2024/0188, 2023/1056, 2024/0577, 2024/0551.

Lidhur me pretendimet ankimore 2,3,4,5 Paneli Shqyrtues gjatë senacës së mbajtur me datë 23.09.2024, vërejti se perfaqesuesi i autorizuar nga AK deklaroi se të gjitha çertifikatat e OE te rekomanduar per kontrate gjenden bashklidhur ofertes se dorezuar nga OE i rekomanduar , ateherë me datë 23.09.2024 Paneli Shqyrtues me email ka kerkuar nga AK (zyrtaret e Ministrise se Puneve te Brendshme) qe te beje plotesimin/dorezimin e ketyre çertifikatave pranë OSHP-se , e cila kerkese nga ana e AK -se eshte permbushur me date 24.09.2024 , me ate te cilit email - AK ka zhvedosur nga oferta e OE te rekomanduar vetem çertifikatat per te cilat eshte pretenduar se nuk jane dorezuar. Pranë OSHP -se gjendet email dhe dokumente e prova te cilat argumentojne gjendjen faktike te OE te rekomanduar po ashtu keto çertifikata gjenden edhe ne oferten e dorezuar nga OE i rekomanduar per kontrate ne programin E- prokurimi. Rrjedhimisht mbi bazen e përgjigjes së AK dhe faktimit te këtyre dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar Paneli Shqyrtues konstatoi se keto pretendime ankimore nga OE ankues nuk janë të bazuara. Çështja se a kanë qenë të nevojshme dhe relevante këtë kërkesa për këto certifikata, PSH konsideron se do të duheshin të atakoheshin në fazën e para ofertimit dhe për këto kërkesa sipas nenit 51.3 të LPP bien nën përgjegjësin e AK, citat "*Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse*".

Lidhur me pretendimin ankimore 6 Paneli Shqyrtues nuk ja fali besimin përgjigjës së dhënë të ekpertit shqyrtues dhe teknik në raportin e tyre pasi të njëjtit e kanë zhvlerësuar marrëveshjen e bashkëpunimit në mes të DDD SHPK dhe Lulzim Katanolli, biznes i cili ka ndërruar emrin në Doctor exterminator DDD SHPK, i cili ne oferten e dorezuar ka edhe referencë dhe rrjedhimisht PSH konstaton se OE i rekomanduar për kontratë ka përmbushur kërkesën e vendosur në DT. Kjo kërkesë e DT e vendosur nga AK është për dëshmuar kapacitetin profesional të një OE, dëshmi të cilën e ka të bashkangjitur, ndërsa, është çështje tjetër është aktiviteti i Prokurimit i vitit 2020, se a ka lejuar nën kontraktues apo jo, çështje e cila nuk ka qenë objekt trajtimi në këtë rast.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1", qe njoftimi për dhënie të kontratës te mbetet ne fuqi. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe

dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me “Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender” me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1", PSH konsideron se vendimi i AK te mbetet në fuqi i cili është nxjerrë nga një komision profesional dhe të cilët mbajnë përgjegjësi sipas nenit 59.1 të LPP dhe nën përgjegjësi të AK konform nenit 24.2 të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **Besim A. Zejnullahu B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: